



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

DREJTORIA E PËRGJITHSHME RREGULLATORE PËR ARSIMIN DHE SPORTIN

Nr. 4833 / Prot.

Tiranë, më 31 . 7 . 2024

Lënda: Dërgohet urdhri për njohje dhe zbatim

UNIVERSITETIT "NEW YORK", TIRANË

Adresa: Rruga "Muhamet Gjollësia", Lagjia 21 Dhjetori, Tiranë

Bashkëlidhur gjeni për njohje dhe zbatim urdhrin e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit nr.390, datë 29.07.2024 , "Për riorganizimin e programit të studimit të ciklit të tretë, Doktoratë në "Shkenca Kompjuterike", në Universitetin e New York-ut, në Tiranë".

Duke ju falënderuar,

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

Erzen Toza





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT



Nr. 4833/1 Prot.

Tiranë, më 29 7 2024

URDHËR

NR. 390, DATË 29.07.2024.

PËR

**RIORGANIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË TRETË,
DOKTORATË NË "SHKENCA KOMPJUTERIKE", NË UNIVERSITETIN E NEW
YORK-UT NË TIRANË**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë dhe të neneve 35 dhe 77, të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", si dhe shkronjës "g", të pikës 2, të urdhrit nr. 113, datë 26.03.2024, të ministrit të Arsimit dhe Sportit, "Për delegimin e kompetencave dhe caktimin e detyrave të zëvendësministrit të Arsimit dhe Sportit, znj. Ana Kapaj", i ndryshuar.

URDHËROJ:

1. Riorganizimin për shkak të ligjit të programit të studimit të ciklit të tretë, "Doktoratë" në "Shkenca Kompjuterike", në Universitetin e New York-ut në Tiranë, që do të zhvillohet në gjuhën angleze, me kod 83DO0688A.
Studimet e doktoratës të zhvillohen me kohë të plotë pranë njësisë/ve bazë ose me kohë të zgjatur në ato raste kur doktoranti është i punësuar si personel akademik në një institucion tjetër të arsimit të lartë, apo si personel kërkimor në një institucion të kërkimit bazë ose të zbatuar.
Në përfundim të këtij programi studimi lëshohet diplomë e gradës shkencore "Doktor" në "Shkenca Kompjuterike" në Fakultetin e Inxhinierisë dhe Arkitekturës, në Universitetin e New York-ut në Tiranë, referuar nivelit 8, të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.
2. Veprimtaria akademike në programin e përbashkët të studimit të ciklit të tretë "Doktoratë" në "Shkenca Kompjuterike", në Fakultetin e Inxhinierisë dhe Arkitekturës, në Universitetin e New York-ut në Tiranë, fillon sipas legjislacionit në fuqi.
3. Universiteti i New York-ut në Tiranë, të respektojë kriteret për personelin akademik të angazhuar për programin e studimit, lidhur me numrin maksimal të udhëheqjeve që mund të kenë në të gjitha IAL-të, në varësi të titullit akademik që zotëron udhëheqësi, në bazë të legjislacionit në fuqi.

4. Universiteti i New York-ut në Tiranë, të marrë masa që programi i studimit t'i nënshtrohet procesit të akreditimit, sipas afateve të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.
5. Universiteti i New York-ut në Tiranë, të zbatojë procedurat e aplikimit për regjistrimin e formës së diplomës së këtij programi studimi, pranë Qendrës së Shërbimeve Arsimore dhe të përshtatë aktet e brendshme rregullatore, në zbatim të këtij urdhri.
6. Universiteti i New York-ut në Tiranë, të ndjekë procedurat për regjistrimin e gradës shkencore "Doktor" në regjistrin shtetëror të gradave shkencore dhe titujve akademikë, pranë strukturës përgjegjëse kompetente.
7. Ministria e Arsimit dhe Sportit ushtron kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucionin e arsimit të lartë, në zbatim të këtij urdhri.
8. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtorja e Përgjithshme Rregullatore për Arsimin dhe Sportin, në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit, Qendra e Shërbimeve Arsimore dhe Universiteti i New York-ut në Tiranë.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSMINISTRI

ANA KAPAJ

